



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA KOMERCIALE

Numri i lëndës: 2024:060757

Datë: 13.09.2024

Numri i dokumentit: 06160960

KPPP.nr. 380/24

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS - Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Ekonomike, Gjyqtari Florent Zeqiri, në çështjen përmbartimore të kreditorit Mercedes Benz Service Muçiqi, me numër unik identifikues 810199051, të cilin sipas autorizimit e përfaqëson Merita Stublla Emimi, avokate nga Prishtina, kundër debitorit Prince Coffee House Sh.P.K., me numër unik identifikues 811251595 dhe me seli në Magjistralen Prishtinë – Fushë Kosovë, Ish Fabrika e Amortizatorëve, të cilin sipas autorizimit e përfaqëson A.Q., duke vendosur lidhur me prapësimin e debitorit të ushtruar kundër Urdhrit Përmbartimor P.nr. 046/24, të datës 31.01.2024, të lejuar nga Përmbartuesi Privat Rezarta Metaj nga Prishtina, jashtë seancës me datën 13.09.2024, merr këtë:

A K T V E N D I M

- I. REFUZOHET në tërësi si i pa bazuar prapësimi i debitorit Prince Coffee House Sh.P.K., nërsa Urdhri Përmbartimor P.nr. 046/24 i datës 31.01.2024, i lejuar nga Përmbartuesi Privat Rezarta Metaj, MBETET NË FUQI.
- II. OBLIGOHET debitori që në emër të shpenzimeve për përpilimin e përgjigjes në prapësim, t'ia paguaj kreditorit shumën e përgjithshme prej EUR 78.00 (shtatëdhjetë e tetë euro), në afat prej 7 (shtatë) ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktvendimi.

A r s y e t i m

Përmbartuesi Privat, duke vepruar sipas propozimit të kreditorit Mercedes Benz Service Muçiqi, me datë 31.01.2024 ka lëshuar urdhrin P.nr. 046/24, duke lejuar përmbartimin në bazë të dokumentit Faturë nr. 1439/22, e datës 29.09.2022 me të cilin e ka urdhëruar debitorin Prince Coffee House Sh.P.K., që në emër të borxhit të përcaktuar sipas faturës së lartcekur t'ia paguaj

kreditorit shumën prej 150.00 EUR (njëqind e pesëdhjetë euro), së bashku me kamatë ligjore prej 8% si dhe shpenzimet e procedurës përmbarimore.

Debitori, përmes përfaqësues së autorizuar, brenda afatit ligjor ka parashtruar prapësim duke kundërshtuar në tërësi Urdhrin Përmbarimor me arsyetimin se është lejuar në bazë të dokumentit të besueshëm i cili nuk është i vulosur nga ana e debitorit dhe nuk figuron në kartelën financiare të debitorit. Ka shtuar se kreditori nuk i është drejtuar ndonjëherë me kërkesën për pagesë debitorit për të njëjtën faturë, duke qenë se të gjitha faturat tjera që figurojnë në kartelë financiare janë të mbyllura, madje edhe ato të një (1) viti më vonë se fatura që paraqitet si dokument i besueshëm. Për këto arsye, i ka propozuar gjykatës që aprovojë prapësimin e debitorit, ndërsa urdhri përmbarimor të anulohet.

Kreditori, përmes përfaqësues së autorizuar në përgjigjen në prapësim ka kundërshtuar në tërësi pretendimet e debitorit të paraqitura në prapësim me arsyetimin se nuk bazohet në asnjërën nga shkaqet për të cilat mund të paraqitet prapësimi. Më tej, ka theksuar se debitori në vazhdimësi është njoftuar për borxhin edhe përmes email-it zyrtar, mesazheve dhe thirrjeve telefonike, e të cilin borxh debitori nuk e ka kundërshtuar asnjëherë. I ka propozuar gjykatës që të refuzojë prapësimin e debitorit si të pa bazuar, ndërsa urdhri përmbarimor të mbetet në fuqi, si dhe të obligohet debitori që të kompensojë shpenzimet e procedurës përmbarimore, për përpilimin e propozimit për përmbarim në vlerë prej 117.00 EUR dhe përpilimin e përgjigjes në prapësim në vlerë prej 234.00 EUR.

Gjykata, pas shqyrtimit të pretendimeve të palëve ndërgjyqëse, si dhe pas shqyrtimit dhe vlerësimit të provave që gjenden në shkresat e lëndës dhe duke iu referuar dispozitave të nenit 69 dhe 71 të Ligji Nr. 04/L-139 për Procedurën Përmbarimore, (tutje LPP) gjeti se prapësimi i debitorit është i pabazuar për shkaqet si në vijim:

Sipas nenit 29 par.1 të LPP-së, përcaktohet se *“Përmbarimi me qëllim të realizimit të kërkesës në të holla caktohet edhe në bazë të dokumentit të besueshëm”*, ndërsa me nën-par.1.3 të këtij neni fatura përcaktohet si një nga dokumentet e besueshme, kurse me neni 29 par. 3 të LPP-së, përcaktohet se *“Dokumenti i besueshëm është i përshtatshëm për përmbarim po qe se në të është treguar kreditori dhe debitori, si dhe objekti, lloji, shuma dhe koha e përbushjes së detyrimit monetar”*.

Gjykata në rastin konkret vlerëson se Fatura nr. 1439/22 e datës 29.09.2022, i plotëson kushtet për të qenë dokument i besueshëm dhe i përmban të gjitha elementet e kërkuara në përputhje

sipas nenit 29 par. 3 të LPP-së, meqenëse në faturë janë treguar palët, përkatësisht kreditori dhe debitori, janë të përshkruara shërbimet të cilat kanë qenë objekt i faturës, është përcaktuar shuma e cila është detyrim për përmbushje nga ana e debitorit si dhe koha e përmbushjes së këtij detyrimi. Tutje, gjykata gjeti se fatura e lartcekur është pranuar në mënyrë të rregullt nga ana e debitorit, fakt ky që vërtetohet nga nënshkrimi i debitorit në faturë, dhe e njëjta i është bashkangjitur propozimit për përmbardim në origjinal, në përputhje me nenin 37 të LPP-së, dhe si e tillë paraqet bazë për lejimin e përmbardimit pasi që është e përshtatshme për përmbardim.

Gjykata pati parasysh pretendimet e debitorit të paraqitura në prapësim por gjeti se në rastin konkret nuk janë plotësuar asnjë nga kushtet ligjore të përcaktuara me nenin 71 të LPP-së mbi bazën e të cilave do të mund të anulohet urdhri për lejimin e përmbardimit, ndërsa në mbështetje të nenit 73 të LPP-së, lidhur me prapësimin e debitorit ka vendosur jashtë seancës gjyqësore.

Lidhur me shpenzimet e procedurës përmbardimore gjykata vendosi në kuptim të dispozitave të nenit 463 të LPK-së, lidhur me nenin 13 dhe 17 të LPP-së, duke ia njohur shpenzimet përfaqësuesit të kreditorit në emër të përpilimit të përgjigjes në prapësim në vlerë prej EUR 78.00, kjo sipas Rregullores për tarifën e avokatëve e datës 18 mars 2017, lidhur me përmbardimet në bazë të dokumentit të besueshëm me vlerë deri në lartësinë e kontestit të vlerës së vogël.

Nga arsyet e paraqitura më lart dhe duke u bazuar në nenin 73 par të LPP-së, nenin 13 par.1 nën par 1.2 të Ligjit nr. 08/L-015 për Gjykatën Komerciale, u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS

Dhomat e Shkallës së Parë - Departamenti për Çështje Ekonomike

KPPP.nr. 380/24, datë 13.09.2024

Gjyqtari
Florent Zeqiri

KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij aktvendimi palët kanë të drejtë ankese në afat prej shtatë (7) ditëve, nga dita e pranimit të aktvendimit, në Dhomat e Shkallës së Dytë, në Gjykatën Komerciale të Kosovës, përmes Dhomave të Shkallës së parë të kësaj Gjykate.